2012

100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



# EKONOMIA DHE BUXHETI

# Raporti Mujor

## Janar, 2012

*Kontakt:*
*Telefon: ++355 (4) 228 1009*
*e-mail: elami@minfin.gov.al*
www.minfin.gov.al

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE ........................................................................ 2

ZHVILLIMET EKONOMIKE ........................................................................ 3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi mesatar i këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 7
7. Oferta e Parasë 8
8. Depozitat sipas Burimeve 9

SEKTORI FISKAL ........................................................................ 10

1. Buxheti i Konsoliduar 10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 11

ANEKSI STATISTIKOR ........................................................................ 12

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Janar, 2012 arriti në 112.18 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Janar ishte 1.6 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Janar 2012 ishte 107.10 lekë për dollarë dhe 138.32 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Janar shënuan kuotat 6.46 përqind për depozitat 24 mujore, 5.80 për ato 12 mujore, 4.76 për 6 mujorët dhe 4.16 perqind per depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 10.72 përqind për huatë 12 mujore dhe 11.14 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,061.2 miliardë lekë në muajin Janar, duke shënuar një rritje prej rreth 8.1 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave* për vitin 2012 rezultoi me një defiçit të përgjithshëm prej 28.6 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar 2012 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej rreth 1.6 miliardë lekë.
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës Janar 2012, arritën në rreth 25.6 miliardë lekë, ose rreth 93.7 përqind e planit për periudhën.
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 24 miliardë lekë, ose rreth 92.4 përqind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën.

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Janar 2012 pësoi një rritje prej 0.7 përqind krahasuar me muajin Dhjetor dhe Nëntor'11, kur ky indeks shënonte përkatësisht 1.0 përqind dhe 0.1 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin 0.8 përqind, 2.2 përqind dhe 0.2 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit Janar u konstatua në grupin "Ushqime dhe pije joalkolike" me 1.4 përqind. Pesha specifike relativisht e lartë që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çimimeve për këtë grup të kenë efekte mbi normën e inflacionit.

Graf - 1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Janar arriti në 1.6 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2011 dhe 2012 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *2011* | 3.3 | 4.5 | 4.3 | 4.1 | 4.2 | 3.9 |
| *2012* | 1.6 | | | | | |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| *2011* | 3.6 | 3.1 | 2.8 | 3.0 | 2.9 | 1.7 |
| *2012* | | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Janar 2012, arriti në 138.32 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie prej -1.4 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Janar një euro u këmbye me 138.93 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Janar 2012, arriti në 107.10 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 5.9 përqind kundrejt muajit Dhjetor ‘11.

Graf - 2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Janar'12*

Në fund të muajit Janar, dollari amerikan arriti nivelin 105.30 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Janar të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është zhvlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 3.1 përqind dhe është vlersuar kundrejt monedhës europiane, Euro, me 0.2 përqind. Nëncmimi dhe mbicmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 1.292 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet te politkës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Janar 2012, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 5.80 përqind, duke shënuar një rënie prej 0.27 përqind krahasuar me muajin Dhjetor. Rënie për këtë muaj kanë pësuan depozitat për të gjitha afat e maturimit. Depozitat me afat 6-mujor dhe ato me afat 3 – mujor të krahasuara me muajin paraardhës, pësuan një rënie respektivisht me 0.40 përqind dhe 0.26 përqind. Normat e interesit për depozitat me afat 1-mujor pësuan rënie me 0.71 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave me afat 12, 6 dhe 3 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Janar pësoi një rënie me 0.80 pikë përqind, duke arritur në 10.72 përqind nga 11.52 përqind që ishte në muajin Dhjetor. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rënie prej 0.55 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Janar arriti në 11.14 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Janar 2012, për bonot me maturim 12 dhe 6 mujore ishin përkatësisht 7.07 përqind dhe 6.23 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie në Yield-et e bonove të thesarit për të gjitha afatet e maturimit 12 dhe 6 - mujore.

Graf - 3




*Normat e interesit për depozitat*

Graf - 4




*Normat e interesit për huatë*

# 4. Bilanci i Pagesave

Graf - 5




*Bilanci i Pagesave*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Dhjetor 2011 regjistroi nje deficit të përgjithshëm prej 28.6 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6




*Llogaria Korente*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korente prej 1,145.5 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën Janar'11 - Dhjetor'11 rezultoi: *(i)* bilanci tregtar -2,241.6 mln euro, *(ii)* shërbime neto 134.6 mln euro, *(iii)* të ardhura neto 24.2 mln euro, (iv) transferta neto 937.3 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet ne grafikun 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Janar 2012, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth -7,517.3 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2011. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 255.6 milionë lekë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 7,261.7 milionë lekë. Në muajin Janar sistemi bankar rezulton me një rritje prej 47,245.5 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Janar '11, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 39,533.0 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 7,712.5 milionë lekë.

Graf - 7




*Ecuria e M.V.N. te sistemit në Jan'11-Jan'12*

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Janar 2012 arriti në 540.2 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me muajin Janar'11 shënoi vlerën 56.4 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 11.7 përqind. Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 65.4 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 353.2 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 27.5 përqind.

# 7. Oferta e Parasë

Graf-8




*Agregati M3 Jan '11-Jan '12*

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Janar ka shënuar një rënie krahasuar me muajin paraardhës Dhjetor 2011. Kjo ofertë arriti në rreth 1,071 miliardë lekë në fund të muajit Janar duke shënuar një rënie prej 8.9 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në muajin Dhjetor. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 8.1 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.

Graf-9




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 1.4 miliardë lekë në krahasim me muajin Dhjetor.

Graf-10




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Janar, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 85.8 përqind të depozitave totale në valutë.

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Janar 2012 “sektorë të tjerë rezident”, zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 63.5 përqind, ndjekur nga “korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 24.8 përqind dhe nga “korporata publike jofinanciare”, me 9.4 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” dhe “korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 85.8 përqind dhe rreth 11.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i Depozitave të tjera në lekë (95.7 përqind e totalit)

Graf - 11




***Përberja e depozitave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezident” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 769 miliarde) të depozitave totale, prej rreth 873 miliardë lekë në muajin Janar 2012. Ata ndiqen nga “korporata të tjera jofinanciare” (77.7 miliardë), “korporatat të tjera jofinanciare publike” (16.1 miliardë) dhe “korporata të tjera financiare” (7.9 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.5 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Janar 2012, krahasuar me nje muaj më parë Dhjetor 2011 niveli i përgjithshëm i depozitave u ul me 2.2 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe rënies të atyre në valutë.

# SEKTORI FISKAL

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar 2012 janë mbledhur rreth 25.6 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 24 miliardë lekë, që përfshijnë 22.3 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 1.7 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 26.1 % financim i brëndshëm, dhe 73.9 % financim i huaj.

Graf - 12




*Treguesit Fiskal, Janar-2012*

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 7.2 % të të ardhurave buxhetore për planin e vitit 2012, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 6.1 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 6.9 % e planifikimit vjetor të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 2.4 % e planifikimit të tij.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 16.7 miliardë lekë (ose rreth 4.7 % e të Ardhurave Totale Vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 0.8 miliardë lekë (0.2 % e të ardhurave totale vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 5.6 miliardë lekë (1.6 % e të ardhurave totale vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo - tatimore në nivelin e 2.3 miliardë lekë (0.6 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 22.3 miliardë lekë, 5.5 miliardë lekë (24.7 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 2.6 miliardë lekë (11.5 %) për interesat, 2.6 miliardë lekë (11.6 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 0.06 miliardë lekë (0.3 %) për subvencione, 8.3 miliardë lekë (37.2 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe 1.4 miliardë lekë (6.1 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 1.9 miliardë lekë (8.6 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 1.4 % (shpenzime personeli), 0.6 % (shpenzime për interesat), 0.7 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 0.01 % (subvencione), 2.1 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 0.3 % dhe 0.5 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brëndshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 0.1 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është 0.3 %.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar 2012 ishin rreth 25.6 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 23 miliardë, të ardhurat jo - tatimore në rreth 2.3 miliardë.

Tab - 2 *Të ardhurat e realizuara në Janar 2012*

| Burimi | Miliardë Lekë |
|---|---|
| TVSH | 8.4 |
| Tatimi mbi fitimin | 1.0 |
| Taksa doganore | 0.4 |
| Taksat nacionale | 2.0 |
| Akcizat | 2.3 |

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Sufiçiti prej 1.6 miliardë lekë, për periudhën Janar 2012, u mbështet në vlerën (2.2) miliardë lekë nga burime të brëndshme dhe 0.7 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brëndshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Janar 2012, disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 25.574 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 23.997 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për muajin Janar, kontributin kryesorë e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 23.0 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 22.3 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 1.7 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| | Mujor (Monthly ) | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | **2012** | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | **2012** | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | **2012** | Month |
| Janar | 0.5 | 0.4 | 0.9 | 0.8 | 0.7 | 0.50 | 0.40 | 1.00 | 0.80 | 0.70 | 3.0 | 2.1 | 3.6 | 3.3 | 1.6 | January |
| Shkurt | 1.0 | 0.7 | 1.1 | 2.3 | | 0.75 | 0.55 | 1.02 | 1.55 | | 3.6 | 1.9 | 4.7 | 4.5 | | February |
| Mars | 0.9 | 0.6 | 0.1 | -0.1 | | 0.80 | 0.57 | 0.71 | 1.00 | | 4.6 | 1.6 | 4.1 | 4.3 | | March |
| Prill | -0.4 | -0.1 | -0.4 | -0.6 | | 0.50 | 0.40 | 0.42 | 0.60 | | 4.4 | 1.9 | 3.7 | 4.1 | | April |
| Maj | -1.0 | -0.8 | -1.2 | -1.1 | | 0.20 | 0.16 | 0.10 | 0.26 | | 4.2 | 2.1 | 3.3 | 4.2 | | May |
| Qershor | -0.8 | -0.6 | -0.7 | -1.1 | | 0.03 | 0.03 | -0.04 | 0.04 | | 4.0 | 2.3 | 3.2 | 3.9 | | June |
| Korik | -0.6 | -0.7 | -0.5 | -0.7 | | -0.06 | -0.07 | -0.10 | -0.07 | | 3.7 | 2.2 | 3.4 | 3.6 | | July |
| Gusht | 0.6 | 0.7 | 0.8 | 0.3 | | 0.03 | 0.03 | 0.01 | -0.02 | | 2.5 | 2.2 | 3.5 | 3.1 | | August |
| Shtator | 1.1 | 0.8 | 0.7 | 0.4 | | 0.14 | 0.11 | 0.09 | 0.02 | | 2.7 | 2.0 | 3.4 | 2.8 | | September |
| Tetor | 0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.4 | | 0.14 | 0.14 | 0.10 | 0.06 | | 2.8 | 2.3 | 3.0 | 3.0 | | October |
| Nendor | -0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.1 | | 0.12 | 0.16 | 0.11 | 0.06 | | 2.6 | 2.8 | 2.8 | 2.9 | | November |
| Dhjetor | 0.9 | 1.6 | 2.2 | 1.0 | | 0.18 | 0.28 | 0.28 | 0.14 | | 2.2 | 3.7 | 3.4 | 1.7 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

Tab - 2 **Kursi i kembimit**

Exchange rate

ij *(Leke per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 Jan | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhes* | | | | | | *Average of period* |
| USD | 83.89 | 94.98 | 103.94 | 101.17 | 107.10 | USD |
| EURO | 122.80 | 132.06 | 137.79 | 140.30 | 138.32 | EURO |
| *Fundi i periudhes* | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 87.91 | 95.81 | 104.00 | 100.95 | 105.30 | USD |
| EURO | 123.80 | 137.96 | 138.77 | 140.61 | 138.93 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3

Normat e interesit me baze vjetore
Annual Interest Rates

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ne perqindje | | | | | Janar | In percent |
| **Norma e depozitave** | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 6.93 | 6.78 | 6.07 | 6.07 | 5.80 | 12-M |
| 6-M | 5.72 | 5.74 | 5.16 | 5.16 | 4.76 | 6-M |
| 3-M | 5.13 | 5.05 | 4.42 | 4.42 | 4.16 | 3-M |
| 1-M | 4.30 | 4.56 | 4.70 | 4.70 | 3.99 | 1-M |
| **Norma e huase** | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 11.75 | 12.46 | 11.52 | 11.52 | 10.72 | 12-M |
| 6-M | 12.85 | 12.54 | 11.69 | 11.69 | 11.14 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlere** | | | | | | **Securities rates** |
| Bono thesari 1/ | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.27 | 6.30 | 5.29 | 5.29 | ... | 3-M |
| 6-M | 7.45 | 7.52 | 6.41 | 6.41 | 6.23 | 6-M |
| 12-M | 8.56 | 9.14 | 7.09 | 7.09 | 7.07 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2012**
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2012

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke (in million leks)*

| Nr. | E M E R T I M I | Janar January | ITEM | No. |
|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TE ARDHURAVE** | **25,574** | **TOTAL REVENUE** | |
| I. | **Ndihma** | **237** | **Grants** | I. |
| II. | **Te ardhura tatimore** | **23,030** | **Tax Revenue** | II. |
| II.1 | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **16,655** | **From tax offices and customs** | II.1 |
| 1 | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 8,427 | V. A. T | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,011 | Profit Tax | 2 |
| 3 | Akcizat | 2,317 | Excise Tax | 3 |
| 4 | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 2,474 | Personal Income Tax | 4 |
| 5 | Taksa Nacionale dhe te tjera | 2,014 | National Taxes and others | 5 |
| 6 | Taksa Doganore | 412 | Custom Duties | 6 |
| II.2 | **Te ardhura nga Pushteti Lokal** | **764** | **Revenues from Local Gov.** | II.2 |
| 1 | Tatimi mbi pasurine | 136 | Tax on land | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Biznesin e vogel | 198 | Small Business Tax | 2 |
| 3 | Taksa lokale | 430 | Local Taxes | 3 |
| II.3 | **Te ardh Buxh. Pavarur** | **5,611** | **Social ins** | II.3 |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 4,622 | Social Insurance | 1 |
| 2 | Sigurimi Shendetsor | 897 | Health insurance | 2 |
| 3 | Te ardhura per kompensim ne vlere te pronareve | 92 | | |
| III. | **Te ardhura Jotatimore** | **2,307** | **Nontax Revenue** | III. |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 170 | Profit transfer from BOA | 1 |
| 2 | Te ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,383 | Income of budgetary institutions | 2 |
| 6 | Dividenti | 0 | Divident | 4 |
| 7 | Tarifa sherbimesh | 226 | Services | 5 |
| 8 | Te tjera dhe interesa | 528 | Other/not allocated | 6 |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **23,997** | **TOTAL EXPENDITURE** | I. |
| I. | **Shpenzime Korrente** | **22,290** | **Current Expenditures** | I.1 |
| I.1 | **Personeli** | **5,514** | **Personnel expenditures** | 1 |
| 1 | Paga | 4,751 | Wages | 2 |
| 2 | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 763 | Social insurance contributions | 3 |
| 3 | Politikat e reja pagash | | Of which; Contingency | |
| I.2 | **Interesat** | **2,571** | **Interest** | I.2 |
| 1 | Te Brendshme | 2,376 | Domestic | 1 |
| 2 | Te Huaja | 195 | Foreign | 2 |
| I.3 | **Shpenzime Operative Mirembajtje** | **2,583** | **Operational & Maintenance** | I.3 |
| I.4 | **Subvencionet** | **56** | **Subsidies** | I.4 |
| | | | | I.5 |
| I.5 | **Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera** | **8,286** | **Social insurance outlays** | 1.5 |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 6,456 | Social insurance | 1 |
| 2 | Sigurime Shendetsore | 1,830 | Health insurance | 2 |
| 3 | Shpenzime per kompensime ne vlere te pronarve | | Property Compensation | |
| I.6 | **Shpenzime per Buxhetin Lokal** | 1,357 | **Local Budget** | I.6 |
| I.7 | **Shpenzime te tjera sociale** | **1,923** | **Other expenditures** | I.7 |
| 1 | Pagesa e Papunesise | 71 | Unemployment insurance benefits | 1 |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,402 | Social assistance | 2 |
| 3 | Kompensim per ish te perndjekurit politike | 450 | Compensation for ex political prisoners | 3 |
| I.8 | **Trensferime kapitale per llog speciale te shpronsimeve** | | **Property Compensation** | I.8 |
| II. | **Fondi Rezerve** | | **Reserve fund/contigency** | II. |
| III. | **Shpenzime Kapitale** | **1,707** | **Capital expenditures** | III. |
| 1 | Financimi Brendshem | 445 | Domestically financing | 1 |
| 2 | Financimi Huaj | 1,262 | Foreign financed | 2 |
| | nga e cila Bashkia | | | |
| | *Shpronësime* | | | |
| IV | **DEFIÇITI** | **1,577** | **Deficit** | IV |
| IV.1 | **FINANCIMI DEFIÇITIT** | **-1,577** | **Deficit Financing** | IV.1 |
| IV.2 | **Brendshem** | -2,237 | **Domestic** | IV.2 |
| | Te ardhura nga privatizimi | 330 | Privatization receipts | |
| | Hua-marrje e brendeshme | 2,256 | Domestic Borrowing | |
| | Huamarje e brendshme nacionale nga te cilat: | 2,215 | | |
| | Huamarje e brendshme vendori | | | |
| | Te tjera nga të cilat: | | Other | |
| | Depozite e Qeverise ne Banken e Shqiperise | -3,531 | Government deposit at the BoA | |
| | Te tjera | -1,291 | | |
| | Depozite e Sig.Shoqerore dhe Shendetesore | -3,117 | Health and Social Security Deposit | |
| | Mjete ne ruajtje | -75 | | |
| | Principali i nenhuase (Bashkia Tirane=47.3 mln leke) | 251 | The amount of the Loan | |
| | Detyrim ndaj ISSH | -134 | Debt toward H&S Security | |
| | Te tjera (detyrime te perkohshme) | 1,784 | Other (temporary debts) | |
| | **I Huaj** | 660 | **Foreign** | |
| | Hua afatgjate(e marre) | 607 | Long-term Loan(Drawings) | |
| | *nga e cila nenhua* | 40 | | |
| | *Mbeshtetje buxhetore DPL* | | | |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkes* | 416 | Chang. of stat. Account* | |
| | Ripagesat | -363 | Repayments | |

* *"Ndryshimi i gjendjes se arkes" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja*

*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

*Te dhena operative* *preliminary data*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2012**

Table of investments 2012

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar<br>January | |
|---|---|---|
| **Financim i brendshem** | **445** | **Domestic financing** |
| *Ne %* | *26.07* | *In %* |
| **Financim i huaj** | **1,262** | **Foreign financing** |
| *Ne %* | *73.93* | *In %* |
| **Totali *** | **1,707** | **Total** |
| *Ne %* | *100* | *In %* |

*Tek Totali nuk eshte perdfshire zeri - Shpronesime -

Tab - 6

**TE ARDHURAT NGA ZYRAT E DOGANAVE 2012**

**REVENUES FROM CUSTOMS OFFICE 2012**

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar<br>January | |
|---|---|---|
| Takse doganore | 412 | Customs Duties |
| TVSH | 5,847 | V.A.T |
| Akcize | 1,102 | Excises |
| Te tjera | 339 | Others |
| | 331 | |
| **TOTALI I DOGANAVE** | **7,700** | **Total from customs office** |
| **TE ARDHURAT TATIMORE NGA ZYRAT E TATIMEVE DHE INSTITUCIONET BUXHETORE** | | |
| **TAX REVENUES FROM TAX OFFICE AND OTHER INSTITUTIONS** | | |
| TVSH | 2,580 | V.A.T |
| Akciza | 1,215 | Excises |
| Tatimi mbi fitimin | 1,011 | Profit Tax |
| Tatimi mbi te ardhurat personale | 2,469 | Personal income tax |
| Takse nacionale | 1,675 | National taxes |
| **TOTALI I TATIMEVE** | **8,950** | **Total from tax office** |
| **TOTALI I PERGJITHSHEM** | **16,650** | **Total Tax Office** |

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PER 2012
The Deficit and Its Financing for 2012

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *Ne milion leke (In million Leks)*

| | Janar<br>January | |
|---|---|---|
| **Totali i te Ardhurave** | **25,574** | Total Revenues |
| **Totali i Shpenzimeve** | **23,997** | Total Expenditures |
| **Deficiti** | **1,577** | Cash-Balance |
| | | |
| **Financimi i deficitit** | **-1,577** | Deficit Financing |
| **1. I BRENDSHEM** | **-2,237** | Domestic |
| **a. Bono thesari neto** | 3,914 | Treasury bills |
| b.Eurobono | | Eurobonds |
| Eurobono | | *Eurobonds* |
| *kredi nga e cila:* | | Loan from which: |
| *Eurobondi* | | Eurobonds |
| **d. Obligacione** | **-1,699** | Bonds |
| **e. Ndryshimi i gjendjes se arkes** | **-6,648** | Chang. of stat. Account |
| Depozitat e qev. ne Banken e Shqip. | -3,531 | Deposit of Government in B.O.A |
| Depoz. e Sigurimit Shoq. & Shend. | -3,117 | Deposit of Social & Health Ins. |
| f. Mjete ne ruajtje | -75 | Deposit of Government in B.O.A |
| g. Te ardhura nga privatizimi | 330 | Privatization receipts |
| **h. Te tjera detyrime** | **1,901** | Other |
| **Huamarje e brendshme vendori** | **41** | Local Domestic Loan |
| **2.I JASHTEM** | **660** | FOREIGN |
| a. Hua afatgjate | 607 | Long-run Loan |
| *-Marre* | 40 | *Drawings* |
| -Shlyer (Ripagesat) | | Repayments |
| b. Ndryshimi i gjendjes se arkes | 416 | Chang. of stat. Account |
| Ripagesat | -363 | Repayments |

Tab - 8

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

*Ne milion Euro* In millions Euro

| | viti 2010 | viti 2011 | |
|---|---|---|---|
| **Llogaria korente** | **-1,018.6** | **-1,145.5** | **Current Account.** |
| **Bilanci tregetar** | **-2,082.7** | **-2,241.6** | **Trade Balance.** |
| Eksporti I mallrave fob | 1,171.50 | 1,405.50 | Merchandise Exports. Fob |
| Importi I mallrave fob | -3,254.20 | -3,647.10 | Merchandise Imports. Fob |
| **Bilanci i sherbimeve** | **231.80** | **134.60** | **Services Balance.** |
| Sherbimet Kredi | 1,750.70 | 1,747.40 | Services Credit |
| Sherbimet Debi | -1,518.90 | -1,612.80 | Services Debt |
| **Bilanci i te ardhurave** | **-90.10** | **24.20** | **Balance of Incomes** |
| Te ardhurat Kredi | 286.30 | 231.50 | Income Credit |
| Te ardhurat Debi | -376.40 | -207.30 | Income Debt |
| **Bilanci i transfertave** | **922.40** | **937.30** | **Balance of Transfers** |
| Transferta private | 877.10 | 916.40 | Private Unrequired Transfers |
| Transfertat shteterore | 45.30 | 20.90 | Offical Unrequired Transfers |
| **Llogaria kapitale** | **85.50** | **84.90** | **Capital Account** |
| **Llogaria financiare** | **786.50** | **836.40** | **Financial Account** |
| Investime direkte | 788.50 | 711.80 | Direct Investment |
| Investime portofoli | 232.10 | -82.50 | Portofolio Investment |
| Kapitale te tjera | -224.90 | 215.80 | Other Capital |
| **Gabime dhe harresa neto** | **325.40** | **195.60** | **Net errors and omissions** |
| **Bilanci i pergjithshem** | **178.80** | **-28.60** | **Overall Balance** |
| Rezervat | -178.80 | 28.60 | Reserve Assets |
| Perdor kred & huash nga FMN | -9.20 | -8.70 | Use of Fund Credit and Loans |

*Burimi : BSH* *Source : Bank of Albania*

Tab - 9 **MJETET VALUTORE NETO**
Net Foreign Assets

| Ne milione leke / Fundi i periudhes | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 Janar / Jan | Millions of leke / End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mjetet valutore neto** | **201,191.1** | **214,466.8** | **252,827.8** | **255,657.9** | **255,402.3** | **Net Foreign assets** |
| **Predendime ndaj jorezidenteve** | **215,529.3** | **236,223.3** | **274,628.2** | **276,475.7** | **277,267.1** | **Claims on non-rezidents** |
| **Minus: Detyrime ndaj jorezidenteve** | **14,338.2** | **21,756.6** | **21,800.3** | **20,817.8** | **21,864.8** | **Minus: Liabilities to non-residents** |
| | | | | | | |
| **Mjetet e brendshme** | **85,397.1** | **105,263.2** | **72,244.3** | **84,492.3** | **80,068.8** | **Domestic Assets** |
| **Pretendimet neto ndaj qeverise qendrore** | **64,073.6** | **71,369.8** | **57,937.1** | **57,098.1** | **54,058.4** | **Net Calims on Central Government** |
| **Minus: Detyrime ndaj qeverise qendrore** | **19,354.6** | **10,919.7** | **8,991.7** | **10,492.8** | **13,466.4** | **Minus: Due to Central Government** |
| **Pretendime ndaj korporatave te tjera depozituese** | **20,141.9** | **32,372.6** | **12,535.6** | **10,492.8** | **13,466.4** | **Claims on other depository corporations** |
| Depozita | - | - | - | - | - | Deposits |
| Hua | 20,141.0 | 32,371.7 | 10,763.9 | 8,584.3 | 11,537.8 | Loans |
| Llogari te tjera | 0.9 | 0.8 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Other accounts |
| Pretendime ndaj korporatave te tjera financiare | - | - | - | - | - | Claims on other financial corporations |
| Pretendime ndaj korporateve jofinanciare publike | - | - | - | - | - | Claims on public non-financial corporations |
| Pretendime ndaj korporatave te tjera jofinanciare | - | - | - | - | - | Claims on other non-financial corporations |
| Pretendime ndaj sektoreve te tjere rezidente | 1,181.6 | 1,520.9 | 1,771.7 | 1,908.5 | 1,928.6 | Claims on other resident sectors |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 10 **KREDIA PER EKONOMINE**
Credit to Economy

| Ne milion leke<br>Fundi I periudhes | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012<br>Janar<br>Jan | Million of leks<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali I kredise** | **396,231.0** | **440,397.4** | **483,044.8** | **541,899.9** | **540,255.0** | **Total Credit** |
| **Kredia per qeverine lokale** | **-** | **-** | **-** | **147.20** | **144.60** | **Credits to local Government** |
| Ne leke | - | - | - | 147.20 | 144.60 | in lek |
| Ne valute | - | - | - | - | - | in Foreingn Currency |
| | | - | - | | | |
| **Kredia per korporatat jofinanciare publike** | **12,899.1** | **12,056.3** | **9,373.9** | **18,678.5** | **18,604.7** | **Credits to Public Non-financial Corporations** |
| Ne leke | 3,636.7 | 6,323.5 | 5,022.9 | 8,446.2 | 8,430.7 | in lek |
| Ne valute | 9,262.4 | 5,732.8 | 4,351.0 | 10,232.3 | 10,174.0 | in Foreingn Currency |
| **Kredia per korporatat jofinanciare private** | **242,050.6** | **275,479.8** | **315,879.1** | **364,373.9** | **362,673.9** | **Credits to other Non-financial Corporations** |
| Ne leke | 49,111.0 | 70,353.3 | 83,234.9 | 108,321.7 | 106,505.9 | in lek |
| Ne valute | 192,939.7 | 205,126.5 | 232,644.2 | 256,052.2 | 256,168.0 | in Foreingn Currency |
| **Kredia per korporatat e tjera financiare** | **376.2** | **6,032.3** | **8,704.5** | **9,841.9** | **9,995.2** | **Credits to Other Financial Corporations** |
| Ne leke | 334.7 | 816.3 | 2,957.0 | 3,364.2 | 3,363.6 | in lek |
| Ne valute | 41.5 | 5,216.0 | 5,747.5 | 6,477.7 | 6,631.6 | in Foreingn Currency |
| **Pretendime per sektore te tjere rezidente** | **140,905.1** | **146,829.0** | **149,087.3** | **148,858.4** | **148,836.6** | **Claims to other Resident Sectors** |
| Ne leke | 60,936.2 | 62,986.8 | 65,897.5 | 68,499.9 | 68,612.9 | in lek |
| Ne valute | 79,968.9 | 83,842.3 | 83,189.8 | 80,358.5 | 80,223.7 | in Foreingn Currency |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 11 **OFERTA E PARASE**
Money Supply

Mujor-Monthly

| Ne milion leke / Fundi I periudhes | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 Janar / Jan | Millions of LEK / End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Baza monetare** | 271,729.2 | 284,839.7 | 283,453.5 | 289,809.5 | 284,001.4 | **Base Money** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 19.1 | 4.8 | -0.5 | 5.4 | 2.7 | Y/Y change in % |
| **Paraja jashte korporatave depozituese** | 195,808.5 | 209,043.8 | 195,059.0 | 194,923.4 | 188,208.6 | **Currency Outside Depository** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 26.4 | 6.8 | -6.7 | -0.1 | 0.9 | Y/Y change in % |
| **Depozita** | 619,790.4 | 662,425.7 | 785,225 | 875,230 | 873,005.9 | **Deposits** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 2.8 | 6.9 | 18.5 | 10.5 | 9.8 | Y/Y change in % |
| **Agregati M1** | 282,853.5 | 284,505.6 | 275,427.3 | 276,898.3 | 265,229.6 | **M1 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 16.6 | 0.6 | -3.2 | 0.5 | 0.7 | Y/Y change in % |
| **Agregati M2** | 554,908.7 | 578,181.5 | 604,517.3 | 647,007.8 | 641,761.1 | **M2 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 9.6 | 4.2 | 4.6 | 7.0 | 6.7 | Y/Y change in % |
| **Agregati M3** | 815,598.9 | 871,469.5 | 980,283.9 | 1,070,153.7 | 1,061,214.5 | **M3 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 7.7 | 6.8 | 12.5 | 9.2 | 8.1 | Y/Y change in % |
| **Burimet e bazes monetare** | | | | | | **Bonetary Base sources** |
| Mjetet e huaja neto | 201,191.1 | 214,466.8 | 252,827.8 | 255,657.9 | 255,402.2 | Net foreign assets |
| Mjetet e brendshme neto | 85,397.1 | 105,263.2 | 72,244.3 | 84,492.3 | 80,068.8 | Domestic assets |
| Pretendimet ndaj qeverise qendrore neto | 64,073.6 | 71,369.8 | 57,937.1 | 57,098.1 | 54,058.4 | Net Claims on central government |
| Pretendimet ndaj korporatave te tjera depozituese | 20,141.9 | 32,372.6 | 12,535.6 | 25,485.8 | 24,081.7 | Clains on other depository corporatons |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 12 **DEPOZITAT**
Deposits

| Ne milione leke / Fundi i periudhes | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 Janar / Jan | Millions of Leks / End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Në lekë** | **359,187** | **369,138** | **409,459** | **452,085** | **453,552** | **In national currency** |
| **Depozitat e transferueshme +Depozita me likuiditet të lartë (depozita** | **70,355** | **61,372** | **80,369** | **81,975** | **77,021** | **Transferable deposits+Liquid deposits** |
| Qeveria lokale | 482.8 | 478.1 | 948.1 | 1,157.4 | 1,347.8 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 698.2 | 7,687.7 | 7,134.0 | 7,303.4 | 7,232.6 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 6,768.7 | 675.3 | 920.6 | 532.5 | 384.6 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 33,320.4 | 20,574.7 | 22,505.0 | 20,681.5 | 19,122.8 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 29,085.2 | 31,956.3 | 48,860.8 | 52,300.1 | 48,933.1 | Other resident sectors |
| | | | | | | |
| **Depozita të tjera** | **272,142** | **293,676** | **329,090** | **370,110** | **376,532** | **Other deposits** |
| Qeveria lokale | 17.7 | 8.4 | 55.1 | 109.6 | 29.1 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 831.8 | 3,378.4 | 3,054.3 | 2,608.9 | 3,584.2 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 1,331.5 | 786.6 | 1,773.4 | 1,423.5 | 2,027.0 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 9,428.6 | 9,898.3 | 8,316.8 | 11,292.5 | 10,376.9 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 260,532.8 | 279,604.3 | 315,890.5 | 354,675.1 | 360,514.3 | Other resident sectors |
| | | | | | | |
| **Në valutë** | **260,700** | **293,288** | **375,767** | **423,146** | **419,453** | **In foreign currency** |
| Qeveria lokale | 279.5 | 313.0 | 493.0 | 280.5 | 210.6 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 2,339.8 | 6,771.0 | 6,201.0 | 5,242.2 | 5,327.8 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 8,089.6 | 3,672.8 | 8,572.0 | 6,022.3 | 5,546.5 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 45,922.9 | 39,582.9 | 57,382.9 | 54,418.4 | 48,276.1 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 204,068.1 | 242,948.4 | 303,117.7 | 357,182.4 | 360,092.4 | Other resident sectors |
| | | | | | | |
| **Totali** | **619,107** | **661,626** | **785,225** | **875,230** | **873,006** | **Total** |
| Qeveria lokale | 780 | 799 | 1,496.2 | 1,547.5 | 1,588 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 3,870 | 17,837 | 16,389.3 | 15,154.5 | 16,145 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 16,655 | 5,243 | 11,266.0 | 7,978.3 | 7,958 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 88,934 | 70,361 | 88,204.7 | 86,392.4 | 77,776 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 509,649 | 568,186 | 667,869.0 | 764,157.6 | 769,540 | Other resident sectors |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 13 **BILANCI I PERMBLEDHUR I BSH**
Consolidated BoA Balance sheet

| Ne milion leke<br>Fundi I periudhes | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012<br>Janar<br>Jan | Millions of Lek<br>End of period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | **326,406** | **359,552** | **368,032** | **384,581** | **384,381** | **ASSET** |
| **Total** | **65,798** | **62,644** | **50,480** | **48,572** | **45,633** | **Total** |
| Mbajtjet e SDR | 641.8 | 7,546.1 | 8,126.9 | 8,226.5 | 8,010.4 | SDR holdings |
| Arka ne valute | 1,068.6 | 705.8 | 647.0 | 59.8 | 70.3 | Foreign currency |
| Depozitat | 64,088 | 54,392 | 41,705.7 | 40,286.0 | 37,552.3 | Deposits |
| **Letrat me vlere te ndryshme nga aksionet** | **218,120** | **243,143** | **280,301** | **284,210** | **285,949.5** | **Securities other than shares** |
| jorezident | 142,952.5 | 165,853.4 | 215,901.8 | 219,718.8 | 221,694.7 | nonresidents |
| qeveria qendrore | 75,167.2 | 77,289.4 | 64,399.2 | 64,490.8 | 64,254.8 | central government |
| **Huate** | **24,319** | **33,885** | **14,302** | **27,388** | **26,004** | **Loans** |
| Qeveria qendrore | 3,000.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Central Government |
| Korporata te tjera depozituese | 20,141.0 | 32,371.7 | 12,534.8 | 25,485.4 | 24,081.3 | Other depository corporations |
| Sektore te tjere rezidente | 1,177.6 | 1,513.5 | 1,767.3 | 1,902.8 | 1,923.0 | Other resident secotrs |
| **Derivatet financiare** | **0.0** | **10.7** | **81** | **35** | **22.4** | **Financial derivatives** |
| **Llogari te arketueshme** | **12,891.3** | **13,279.2** | **10,748.3** | **11,295.9** | **13,230.1** | **Receivable accounts** |
| **Mjetet jofinanciare** | **5,278.7** | **6,590.9** | **12,119.1** | **13,080.0** | **13,541.5** | **Nonfinacial assets** |
| **DETYRIMET** | **326,406** | **359,552** | **368,032** | **384,581** | **384,381** | **LIABILITIES** |
| **Total** | **203,936** | **216,768** | **202,644** | **203,009** | **198,104** | **Total** |
| Para ne qarkullim | 203,732.8 | 216,767.6 | 202,386.7 | 202,906.6 | 197,613.4 | Currency in Circulation |
| Depozitat e perfshira ne parane e gjere | 203.1 | 0.6 | 256.8 | 102.8 | 490.8 | Deposits included in broad money |
| **Depozita te paperfshira ne parane e gjere** | **94,815** | **87,661** | **98,842** | **108,017** | **112,251** | **Deposits excluded from broad money** |
| jorezident | 6,783.7 | 7,981.6 | 8,440.3 | 8,318.7 | 9,603.7 | nonresidents |
| qeveria qendrore | 19,334.8 | 10,897.5 | 8,966.2 | 10,465.6 | 13,446.9 | central government |
| korporata te tjera depozituese | 67,793.3 | 68,071.5 | 80,810.0 | 88,570.2 | 87,644.9 | other depository corporations |
| korporata te tjera jofinanciare | 12.2 | 17.0 | 14.9 | 20.5 | 20.8 | other nonfinancial corporations |
| sektore te tjere rezidente | 890.7 | 692.9 | 610.4 | 641.5 | 1,534.3 | other resident sectors |
| **Huate** | **1,173** | **1,269** | **5,921** | **4,852** | **4,690** | **Loans** |
| Jorezidentet | 1,173 | 1,269 | 5,921 | **4,852** | 4,690 | Nonresidents |
| Qeveria qendrore | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Central Government |
| Korporata te tjera depozituese | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Other depository corporations |
| **Llogari te pagueshme** | **7,024.2** | **6,903.5** | **936.4** | **1,064.3** | **997.2** | **Other accounts payable** |
| **Alokimi I SDR** | **0.0** | **6,954.1** | **7,439.5** | **7,647.1** | **7,571.6** | **SDR allocation** |
| **Aksione dhe insturmenta te tjere** | **19,458** | **39,997** | **52,249.7** | **59,992.0** | **60,767.6** | **Shares and other equity** |

*Burimi : BSH* *Source : Bank of Albania*